



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS
TABLE TENNIS FEDERATION OF KOSOVA

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË PINGPONGUT 2025-2030

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Shkurtesat	3
Hyrja	4
Vizioni	5
Analiza e gjendjes ekzistuese	6
Zhvillimi i cilësisë dhe arritja e rezultateve të larta.....	7
Pingpongu për të gjithë dhe identifikimi i talentëve.....	8
Diplomacia sportive dhe promovimi i vlerave shoqërore.....	9
Infrastruktura sportive dhe organizimi i garave.....	10
Qeverisja e mirë dhe burimet njerëzore.....	12
Analiza SWOT.....	13
Analiza PESTLE.....	15
Objektivat strategjike dhe specifike	16
Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i cilësisë dhe arritja e rezultateve të larta ndërkombëtare.....	16
Objektivi strategjik 2: Masovizimi i pingpongut dhe forcimi i lidhjes me komunitetin.....	17
Objektivi strategjik 3: Diplomacia, turizmi sportiv dhe promovimi i vlerave shoqërore.....	18
Objektivi strategjik 4: Qeverisje e mirë, ngritje e kapaciteteve institucionale dhe infrastrukturë moderne.....	19
Plani i Veprimit	21
Plani i veprimit për Objektivin Strategjik 1.....	21
Plani i veprimit për Objektivin Strategjik 2.....	22
Plani i veprimit për Objektivin Strategjik 3.....	23
Plani i veprimit për Objektivin Strategjik 4.....	23
Planifikimi i Buxhetit	25
Burimi i Financimit.....	25
Projeksioni progresiv i buxhetit vjetor 2025-2030.....	26
Korniza orientuese e shpërndarjes buxhetore sipas objektivave strategjike.....	26
Implementimi, Monitorimi dhe Rishikimi Buxhetor.....	27
Monitorimi dhe evaluimi – KPI	28
Parimet e monitorimit dhe evaluimit.....	28
KPI – Objektivi strategjik 1.....	28
KPI – Objektivi strategjik 2.....	29
KPI – Objektivi strategjik 3.....	29
KPI – Objektivi strategjik 4.....	30
Plani i veprimit në rast krizash	32

Shkurtesat

FPPK	Federata e Pingpongut e Kosovës
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë e Sportit
KOK	Komiteti Olimpik i Kosovës
OJQ	Organizata Joqeveritare
ITTF	International Table Tennis Federation
ETTU	European Table Tennis Federation
WTT	World Table Tennis
MTTU	Mediterranean Table Tennis Union
BTTU	Balkan Table Tennis Union
EYOF	European Youth Olympic Festival
OS	Objektiv Strategjik
KPI	Key Performance Indicator
EU/BE	Bashkimi Evropian

Hyrja

Strategjia e Zhvillimit të Pingpongut në Kosovë 2025–2030 paraqet dokumentin kryesor orientues për drejtimin, modernizimin dhe fuqizimin e këtij sporti në nivel kombëtar. E harmonizuar me Ligjin Nr. 08/L-277 për Sport, Strategjinë Shtetërore për Sport 2025–2030 dhe me praktikat ndërkombëtare të ITTF dhe ETTU, ajo përfaqëson zotimin e Federatës së Pingpongut të Kosovës (FPPK) për të avancuar qeverisjen, për rritur cilësinë dhe për të ndërtuar një ekosistem të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës.

Pingpongu në Kosovë ka kaluar një proces të vazhdueshëm zhvillimi, nga konsolidimi i strukturave organizative dhe pjesëmarrjet e para ndërkombëtare, deri te afirmimi i talentëve vendorë dhe organizimi i eventeve të rëndësishme në vend. Strategjia 2025–2030 ndërtohet mbi këto arritje, duke synuar të forcojë bazat ekzistuese dhe të hapë rrugë drejt një faze të re profesionalizimi dhe rritjeje.

Ky dokument shërben si udhërrëfyes për zhvillimin e pingpongut në të gjitha nivelet, duke përfshirë punën me fëmijët dhe të rinjtë, mbështetjen e lojtarëve elitare, masovizimin, rritjen e cilësisë së garave, fuqizimin e klubeve, diplomacinë sportive, përmirësimin e infrastrukturës dhe promovimin e vlerave sportive. Strategjia siguron qasje të drejtë dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë sportistët.

Procesi i hartimit ka qenë gjithëpërfshirës, duke konsultuar dhe angazhuar klube, trajnerë, sportistë, institucione dhe ekspertë të fushës. Këto konsultime kanë garantuar që prioritetet të bazohen në sfidat dhe nevojat reale të komunitetit, duke e bërë strategjinë të zbatueshme dhe të mbështetur gjerësisht.

Në përputhje me vizionin e federatës dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare, dokumenti përcakton prioritetet, objektivat, rezultatet e synuara dhe mekanizmat e monitorimit, të cilat do të konkretizohen në Planin Operacional shoqërues.

Në thelb, Strategjia e Zhvillimit të Pingpongut 2025–2030 synon ngritjen e cilësisë sportive, fuqizimin e klubeve, rritjen e pjesëmarrjes, përmirësimin e rezultateve ndërkombëtare dhe forcimin e imazhit të Kosovës, me theks të veçantë synimin për rezultate kulmore në Lojërat Mesdhetare 2030.

Vizioni

“Pingpong cilësor, gjithëpërfshirës dhe i suksesshëm ndërkombëtarisht.”

Vizioni i kësaj strategjie është ngritja e cilësisë së pingpongut në Kosovë në të gjitha nivelet, nga baza deri te niveli elitar duke krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, që nxit talentin dhe promovon pjesëmarrjen gjatë gjithë jetës.

Deri në vitin 2030, pingpongu do të njihet gjerësisht në Kosovë edhe si mjet për edukim duke krijuar një lidhje më të fortë në mes klubeve, shkollave dhe komunitetit për të integruar pingpongun si pjesë të zhvillimit të të rinjëve, edukimit dhe përfshirjes sociale me qëllim të krijimit të rrugëve të qarta për përfshirjen e të gjithë personave pa dallim moshe, gjinie qoftë përmes pjesëmarrjes në menyrë rekreative apo garuese.

Në nivel elitar, vizioni parasheh ngritjen e cilësisë teknike dhe organizative, forcimin e klubeve dhe rritjen e performancës ndërkombëtare, me synimin për rezultate të larta në arenën ndërkombëtare, me theks të veçantë në Lojërat Mesdhetare 2030. Përmes qeverisjes së mirë, diplomacisë sportive, organizimit cilësor të garave dhe infrastrukturës së zhvilluar, FPPK synon të kontribuojë në imazhin pozitiv të Kosovës.

Analiza e gjendjes ekzistuese

Zhvillimi i sportit të pingpongut në Kosovë është i ndikuar nga një kombinim faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm që formësojnë funksionimin e Federatës së Pingpongut të Kosovës (FPPK).

Aktualisht, pjesë e FPPK-së janë 45 klube të meshkujve dhe femrave, të cilat zhvillojnë garat në tri kategori të ndryshme, me gjithsej 626 sportistë prej tyre 413 pingpongistë aktivë dhe 45 trajnerë, ndërsa numri i madh i garave të organizuara gjatë vitit reflekton funksionim aktiv, por jo domosdoshmërisht performancë cilësore në nivel elitar.

Table 1 - Struktura e Klubeve të FPPK-se

<i>Kategoria</i>	<i>Numri Total</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>
<i>Klube gjithsej</i>	45	35	10
<i>Superliga</i>	14	8	6
<i>Liga e Parë</i>	12	8	4
<i>Liga e Dytë</i>	19	19	0

Table 2 - Struktura e sportistëve të regjistruar në klube

<i>Kategoria</i>	<i>Numri Total</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>
<i>Pingpongistë gjithsej</i>	413	310	103
<i>Seniorë</i>	164	147	17
<i>U21</i>	10	5	5
<i>U19</i>	23	18	5
<i>U17</i>	49	31	18
<i>U15</i>	59	34	25

<i>U13</i>	55	39	16
<i>U11</i>	38	26	12
<i>U9</i>	15	10	5

Table 3 Numri i Trajnereve dhe Arbitrave


<i>Kategoria</i>	Numri Total	Meshkuj	Femra
<i>Trajnerë</i>	45	42	3
<i>Arbitra</i>	21	20	1

Këto të dhëna tregojnë se FPPK ka krijuar një bazë të gjerë pjesëmarrjeje, me një numër të konsiderueshëm klubesh dhe sportistësh në grupmosha të ndryshme. Megjithatë, disbalanca gjinore, veçanërisht në nivelin e trajnerëve dhe në ligat e tjera pos superligës, mbetet sfidë e vazhdueshme.

Zhvillimi i cilësisë dhe arritja e rezultateve të larta

Renditjet zyrtare të ITTF tregojnë se Kosova ka një bazë të gjerë sportistësh të renditur në të gjitha kategoritë, por pozitat e tyre në ranglistën botërore mbeten të ulëta në krahasim me standardet ndërkombëtare. Seniorët, si meshkuj ashtu edhe femra, pozicionohen kryesisht në segmentin 840–1050, çka reflekton nivel modest konkurrueshmërie në arenën ndërkombëtare.

Në kategoritë e të rinjve (U19, U17, U15), pozita mesatare varion nga 1200 deri në mbi 1900, duke treguar se edhe pse ka pjesëmarrje të madhe, performanca është ende larg niveleve elitare. Dallimi pozitiv vërehet te grupmoshat më të reja U13 dhe U11, të cilat pozicionohen dukshëm më lart (pozita 300–700), duke sinjalizuar potencial real për investim afatgjatë.



Këto të dhëna sugjerojnë se Kosova ka baza të mira për zhvillim, por i mungon infrastruktura, trajnerët e avancuar dhe programet e synuara të zhvillimit që do ta transformonin këtë potencial në rezultate të qëndrueshme ndërkombëtare. Në këtë kuptim, renditjet botërore shërbejnë si tregues i qartë i nivelit aktual dhe si orientim për prioritetet strategjike të periudhës 2025–2030.

Pingpongu për të gjithë dhe identifikimi i talentëve

Pingpongu në Kosovë ende nuk disponon një program të mirëfilltë dhe të strukturuar për masivizim dhe identifikim të talentëve. Ka nevojë për më shumë iniciativa të koordinuara në shkolla, lagje, komunitete dhe vende të punës, të cilat do të kontribuonin në zgjerimin e bazës së pjesëmarrësve dhe në zbulimin e talentëve të reja.

Një hap pozitiv në drejtim të masivizimit është përfshirja e pingpongut në programin “Sporti në Shkolla” të MKRS-së. Megjithatë, ndikimi i këtij programi mbetet i kufizuar, pasi deri në dhjetor 2025 vetëm shtatë shkolla janë të përfshira në aktivitetet e pingpongut. Përtej këtij programi, mungojnë aktivitete të qëndrueshme në komunitet, si në lagje, parqe apo qendra rinore, ndërsa vendosja e tavolinave në hapësira publike është minimale dhe nuk krijon ekspozimin e nevojshëm për rritje të pjesëmarrjes.

Krahas kësaj, nuk ekziston asnjë mekanizëm i strukturuar për identifikimin e talentëve, ndërsa

përfshirja e grupeve të marginalizuara, grave dhe pingpongut paralimpik është shumë e ulët. Kjo situatë reflekton mungesën e programeve të dedikuara, partneriteteve me komunat, OJQ-të dhe sektorin privat, si dhe mungesën e një qasjeje integruese për sportin në komunitet.

Krijimi i një mjedisi atraktiv, argëtues dhe të hapur, ku pingpongu lidhet me aktivitete komunitare dhe sporte të tjera, përbën një potencial të pashfrytëzuar. Aktivizimi i këtij potenciali do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e pjesëmarrjes, zbulimin e talenteve dhe krijimin e një strukture të qëndrueshme zhvillimi për brezat e rinj.

Diplomacia sportive dhe promovimi i vlerave shoqërore

Pingpongu ka potencial të konsiderueshëm për të shërbyer si instrument diplomatik dhe promotor i imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. FPPK gëzon marrëdhënie të mira me ITTF, ETTU, BTTU dhe federata të tjera, duke përfaqësuar vendin në struktura rajonale dhe duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Federatën e Turqisë dhe Federatën e Shqipërisë.

Gjithashtu, me federata të tjera kanë nisur bisedime për bashkëpunim, teksa ka filluar organizimi i kampeve të përbashkëta. Disa federata nga shtete të ndryshme kanë shprehur gatishmëri për të zgjeruar bashkëpunimin në të ardhmen. Megjithatë, potenciali i këtyre partneriteteve nuk është shfrytëzuar ende në maksimum dhe mund të zgjerohet tutje.

Në periudhën 2022–2025, aplikimi për projekte dhe grante ndërkombëtare ka qenë i kufizuar, pavarësisht mundësive të rëndësishme financiare që ofron ITTF (deri në 30,000-euro për projekte të ndryshme), si dhe programeve të Bashkimit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Kjo ka kufizuar aftësinë e federatës për të zhvilluar iniciativë të qëndrueshme që do të mbështesnin ngritjen e kapaciteteve, zhvillimin e trajnerëve dhe promovimin ndërkombëtar të sportit.

Gjatë kësaj periudhe nuk janë organizuar konferenca ndërkombëtare, ndërsa diplomacia sportive është zhvilluar kryesisht përmes pjesëmarrjes në takime dhe aktivitete të nivelit protokollar, e jo përmes iniciativave strategjike, projekteve shumëpalëshe apo ngjarjeve të profilit të lartë.

Megjithatë, FPPK ka histori të suksesshme organizimi eventesh të mëdha, si Kampionati Ballkanik 2015 dhe eventet evropiane të vitit 2006. Në vitet e fundit, një hap shumë i

rëndësishëm është bërë me organizimin e “WTT Youth Contender” dhe “WTT Feeder Prishtina” 2024 dhe 2025, ngjarje të cilat shënuan pjesëmarrjen e mbi 600 sportistëve nga 45 shtete. Këto dy gara ndërkombëtare elitare tregojnë se ka kapacitet të riorganizohen ngjarje të mëdha, ndërsa rritja e mëtejshme e numrit të garave ndërkombëtare të organizuara në vend do të kontribuonte në forcimin e identitetit kombëtar, zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rritjen e prezencës së Kosovës në skenën globale të pingpongut.

Infrastruktura sportive dhe organizimi i garave

Infrastruktura aktuale e pingpongut në Kosovë është e pamjaftueshme dhe nuk plotëson standardet moderne për stërvitje dhe gara. Mungon një Qendër Nacionale e Pingpongut, ndërsa shumica e klubeve funksionojnë në ambiente të kufizuara, shpesh me më pak se 8 tavolina dhe pa zhveshtore, kushte përcjellëse apo pajisje profesionale.

Objektet ekzistuese kërkojnë investime të menjëhershme, të tilla si rifreskimi i sallave, ndërrimi i tavolinave, shtimi i kapaciteteve, vendosja e dysHEMEVE Teraflex dhe përmirësimi i ndriçimit e i ngrohjes. Megjithatë federata ka siguruar materiale bazike, vizitat në klube tregojnë se nevojiten ambiente më të përshtatshme dhe pajisje më bashkëkohore.

Stërvitjet janë të kufizuara në kohë dhe intensitet, ndërsa sportistët kanë pak mundësi të marrin pjesë në kampe elitare jashtë vendit. Mungesa e trajnerëve ndërkombëtarë të nivelit të lartë dhe mungesa e programeve të licencimit dhe avancimit profesional e dobësojnë zinxhirin zhvillimor, duke e lënë identifikimin dhe përgatitjen e talenteve kryesisht në nivel klubi, pa koordinim qendror.

Motivimi ekonomik i sportistëve është i ulët, pasi shpërblimet vendore janë minimale, ndërsa mungesa e financimit adekuat pengon investimin në pajisje moderne, staf profesional dhe stërvitje cilësore, duke ndikuar drejtpërdrejt në rezultatet ndërkombëtare.

Organizimi i garave ka nevojë për modernizim. Ka një vëllim të madh aktiviteteve, por sistemi i menaxhimit të tyre është i ngarkuar dhe pa standardizim të plotë.

Table 4 Lista e Eventeve per Vitin 2025

Kategoria	Numri i ditëve të gjarjeve
<i>Gara Individuale Kombëtare</i>	16
<i>Gara Ekipore Kombëtare (Superliga + Ligat)</i>	52
<i>Turne Memoriale / Përkujtimore</i>	9
<i>Evente Ndërkombëtare (ITTF, WTT, ETTU, BTTU, EYOF, etj.)</i>	12
<i>Kupa të Republikës</i>	2
<i>Evente Administrative / Institucionale (regjistrime, kuvende, seminare, shpallje laureatësh)</i>	10
<i>Projekte / Lidhje / Liga të tjera (Mbarëkombëtare, Regional Connect)</i>	2
<i>GJITHSEJ</i>	103 ditë

Table 5 Lista e Eventeve per Vitin 2026

Kategoria	Numri i ditëve të gjarjeve
<i>Gara Individuale Kombëtare</i>	6
<i>Gara Ekipore Kombëtare (Superliga + Ligat)</i>	16
<i>Turne Memoriale / Përkujtimore</i>	6
<i>Evente Ndërkombëtare (ITTF, WTT, ETTU, BTTU, EYOF, etj.)</i>	19
<i>Kupa të Republikës</i>	2
<i>Evente Administrative / Institucionale (regjistrime, kuvende, seminare, shpallje laureatësh)</i>	7
<i>Projekte / Lidhje / Liga të tjera (Mbarëkombëtare, Regional Connect)</i>	2
<i>GJITHSEJ</i>	58 ditë

Mungesa e digjitalizimit mbetet një mangësi thelbësore strukturore: rezultatet nuk publikohen në kohë reale, nuk ekziston një databazë funksionale e sportistëve, klubeve dhe statistikave, dhe kjo ndikon drejtpërdrejt në uljen e profesionalizmit dhe transparencës.

Për më tepër, federata mbështetet pothuajse tërësisht në financimin publik dhe nuk ka shumë sponsorë privatë, gjë që e kufizon aftësinë për të investuar në infrastrukturë moderne, digjitalizim dhe zhvillim afatgjatë.

Qeverisja e mirë dhe burimet njerëzore

FPPK ka bërë përparime të dukshme në zgjerimin e stafit dhe rritjen e aktivitetit të bordit, duke ruajtur një nivel të qëndrueshëm transparence dhe bashkëpunimi me MKRS, KOK dhe komunat. Megjithatë, federata ka ende nevojë për forcim të mëtijshëm të mekanizmave të qeverisjes dhe menaxhimit strategjik.

Mungesa e një organogrami formal, funksionimi i parregullt i komisioneve dhe mungesa e disa dokumenteve kyçe në faqen zyrtare nënvizojnë dobësi strukturore që kufizojnë profesionalizimin institucional.

Përfaqësimi i grave në vendimmarrje mbetet i ulët, ndërsa mungojnë politika të qarta për barazi gjinore. Po ashtu, nuk ekzistojnë programe të zhvilluara për pingpongun paralimpik dhe mungojnë praktikat mjedisore të qëndrueshme (“green practices”), të cilat përbëjnë standarde të rëndësishme në menaxhimin modern sportiv.

Trajnimet për stafin organizativ janë të kufizuara, ndërsa sistemi i arbitrit mbështetet kryesisht në një trajnim vjetor bazik. Kjo situatë ndikon në cilësinë e menaxhimit të garave dhe kufizon zbatimin e plotë të standardeve ndërkombëtare të arbitrit.

Analiza SWOT

Për të kuptuar më mirë pozicionin aktual dhe për të orientuar qartë objektivat strategjike 2025–2030, është realizuar një analizë gjithëpërfshirëse përmes metodës SWOT, e cila përmbledh pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet kryesore të FPPK-së.

Strengths (Pikat e forta)	Weaknesses (Dobësitë)
• Njohje ndërkombëtare dhe marrëdhënie të mira me ITTF, ETTU, BTU dhe federatat rajonale. • Marrëveshje bashkëpunimi me federata nga vende të tjera. • Trajnerë të certifikuar ITTF Niveli I & II. • Kapacitet i dëshmuar për organizimin e ngjarjeve ndërkombëtare. • Bazë e gjerë pjesëmarrësish në garat vendore. • Bordi dhe stafi administrativ kanë shënuar rritje dhe aktivizim. • Bashkëpunim i mirë institucional me MKRS, KOK dhe komunat. • Transparencë dhe llogaridhënie. • Sport ideal për zhvillimin e aftësive kognitive. • Sport ideal për fëmijë, të rinj, veteranë dhe programe për persona me aftësi të kufizuara.	• Rezultate jo të kënaqshme në arenën ndërkombëtare. • Infrastrukturë e kufizuar. • Mungesë investimesh kapitale – mungesa e një Qendre Nacionale të Pingpongut. • Trajnerë vendorë të pakualifikuar për nivelin 3 dhe superior. • Numër i vogël i programeve të avancimit profesional. • Stërvitje të kufizuara në kohë dhe intensitet. • Mungesë kampesh elitare për pingpongistë dhe trajnerë. • Varësi e madhe nga financimi publik - sponsorë privatë të paktë. • Mungesë organogrami • Komisione gjysmë-funksionale, që nuk mbledhen rregullisht. • Përfaqësim i ulët i grave në vendimmarrje. • Mungesë programi paralimpik dhe numër i vogël iniciativash mjedisore (“green practices”). • Mungesë digjitalizimi: s’ka databazë të sportistëve dhe nuk publikohen rezultate live. • Orar i ngarkuar i ngjarjeve. • Mungesë aktiviteteve komunitare dhe mekanizmash të identifikimit të talentëve.

Opportunities (Mundësitë)	Threats (Kërcënimet)
• Potencial për rritje sponsorësh përmes Ligjit për Sponsorizim. • Zgjerimi i programit “Sporti në Shkolla”. • Mundësi financimi nga ITTF, ETTU, EU dhe partnerë ndërkombëtarë. • Investime të mundshme në infrastrukturë nga komunat dhe MKRS. • Partneritete të reja me federata të rajonit dhe më gjerë. • Shfrytëzimi i organizimit të Prishtina Mediterranean Games 2030. • Zhvillimi i programeve paralimpike, programeve ndër-komunitare dhe iniciativave “green sport”. • Shfrytëzimi i social-mediave bashkëkohore që kanë mbulueshmëri të madhe tek moshat e reja.	• Interes i ulët krahasuar me sportet e tjera më të zhvilluara në Kosovë. • Largimi i sportistëve për shkak të mungesës së perspektivës sportive dhe ekonomike. • Rritje e kostove për organizim eventesh ndërkombëtare. • Rreziku i reduktimit të buxheteve publike për sportin. • Varësi nga një bazë e ngushtë trajnerësh dhe arbitrash. • Konkurrencë e fortë nga sporte të tjera për talentet e rinj. • Paqëndrueshmëri politike rajonale që mund të ndikojë garat ndërkombëtare.

Analiza PESTLE

Analiza PESTLE tregon se pingpongu në Kosovë ka një mjedis institucional të favorshëm dhe potencial të madh zhvillimi, por përballët me sfida të rëndësishme ekonomike, teknologjike dhe sociale. Ndërsa mbështetja politike dhe mundësitë e financimit janë të pranishme, infrastruktura e kufizuar, mungesa e digjitalizimit dhe pjesëmarrja e ulët në shkolla e komunitet mbeten sfidat kryesore.

P - Political (Politike)	Organizimi i ngjarjeve ndërkombëtare ofron mundësi të rëndësishme për avancimin e diplomacisë sportive, megjithëse sfidat rajonale politike mbeten faktor ndikues, ndërsa Prishtina Mediterranean Games 2030 krijon një platformë unike për investime dhe pozicionim ndërkombëtar të FPPK-së.
E - Economic (Ekonomike)	Struktura aktuale financiare ka nevojë për forcim, por ligji për sponsorizim dhe aktivitetet ndërkombëtare paraqesin një potencial të rëndësishëm për rritje ekonomike dhe investime kapitale.
S - Social (Sociale)	Zhvillimi i një baze sociale gjithëpërfshirëse po mbështetet nga interesimi në rritje i të rinjve për sportin e pingpongut.
T - Technological (Teknologjike)	Përdorimi i platformave moderne për menaxhim financiar ka rritur efikasitetin, megjithëse ka ende nevojë për digjitalizim të plotë të trajnimeve dhe garave.
L - Legal (Ligjore)	FPPK vepron në përputhje me parimet e ligjit për sportin dhe ligjit për sponsorizim, që kanë luajtur një rol kyç në mbështetjen dhe përmirësimin e transparencës.
E - Environmental (Mjedisore)	Pingpongu ka një ndikim natyrshëm të ulët mjedisor, por mungesa e praktikave të mirëfillta ekologjike e bën të domosdoshme që FPPK të shfrytëzojë këtë potencial dhe të pozicionohet si federatë moderne përmes adoptimit të “green practices” në përputhje me trendet globale të sportit të qëndrueshëm.

Objektivat strategjike dhe specifike

Në funksion të realizimit të vizionit të strategjisë 2025-2030, FPPK-ja ka përcaktuar katër (4) objektiva strategjike, të cilët përbëjnë shtyllat themelore të zhvillimit afatgjatë të pingpongut në Kosovë. Këta objektiva adresojnë prioritetet kryesore të federatës dhe krijojnë një kornizë të qartë për orientimin e politikave, programeve dhe investimeve gjatë periudhës 2025–2030.

1. Zhvillimi i cilësisë dhe arritja e rezultateve të larta ndërkombëtare
2. Masovizimi i pingpongut dhe forcimi i lidhjes me komunitetin
3. Diplomacia, turizmi sportiv dhe promovimi i vlerave shoqërore
4. Qeverisje e mirë, ngritje e kapaciteteve institucionale dhe infrastrukturë moderne

Objektivat strategjike përkthehen në objektiva specifike që trajtojnë sfidat kryesore të sportit të pingpongut dhe synojnë arritjen e rezultateve të matshme në një periudhë më afatshkurtër. Për secilin objektiv specifik janë përcaktuar masat prioritare dhe aktivitetet konkrete që kontribuojnë drejtpërdrejt në realizimin e objektivave strategjike dhe vizionit të federatës.

Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i cilësisë dhe arritja e rezultateve të larta ndërkombëtare

Ky objektiv synon të ndërtojë një cikël të plotë zhvillimor për pingpongun elitare, duke vendosur në qendër ngritjen e nivelit teknik, taktik dhe fizik të sportistëve, si dhe profesionalizimin e stafit trajner dhe organizativ. Qëllimi është të krijohet një sistem modern dhe funksional i performancës së lartë që prodhon rezultate të qëndrueshme dhe konkurruese në garat ndërkombëtare.

Ky objektiv strategjik operacionalizohet përmes objektivave specifike në vijim.

Objektivi specifik 1 - Realizimi i programeve të rregullta të grumbullimeve elitare

Realizimi i së paku 28 grumbullimeve trajnuese për sportistët elitare, me përfshirjen e trajnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë, me qëllim ngritjen e cilësisë teknike dhe konkurrueshmërisë ndërkombëtare.

Objektivi specifik 2 - Identifikimi dhe mbështetja e talentëve të rinj

Identifikimi i së paku pesë sportistëve të rinj me potencial të lartë dhe ofrimi i mbështetjes së

strukturuar për zhvillimin e tyre përmes programeve të Ministrisë së Sportit, ITTF dhe ETTU.

Objektivi specifik 3 - Angazhimi i ekspertizës ndërkombëtare

Angazhimi i së paku një trajneri ndërkombëtar për ngritjen e nivelit të sportistëve dhe trajnerëve vendorë, përmes metodave moderne të stërvitjes dhe transferimit të njohurive.

Objektivi specifik 4 - Zhvillimi i programeve kombëtare të ngritjes së cilësisë

Hartimi dhe implementimi i programeve të posaçme për rritjen e cilësisë së sportistëve dhe zhvillimin e bazës së trajnerëve në të gjitha klubet dhe rajonet e vendit.

Objektivi specifik 5 - Arritja e rezultateve të larta ndërkombëtare

Krijimi i programit të përgatitjes së pingpongistëve për të synuar arritjen e rezultateve të larta në Lojërat Mesdhetare “Prishtina 2030”, përfshirë standardizimin e trajnimeve, strukturimin e përgatitjeve dhe pjesëmarrjen në gara elitare.

Objektivi specifik 6 - Avancimi i organizimit të garave

Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të standardizuar për organizimin e garave vjetore të FPPK-së, në përputhje me kërkesat e ITTF dhe praktikave bashkëkohore. Ky lloj avancimi synon krijimin e një sistemi konkurrues efikas dhe të drejtë, ku pingpongistët garojnë në nivele të përshtatshme me aftësitë e tyre, pa ngarkesa të panevojshme dhe duke optimizuar kohën, energjinë dhe performancën e tyre.

Objektivi strategjik 2: Masovizimi i pingpongut dhe forcimi i lidhjes me komunitetin

Ky objektivi përqendrohet në zgjerimin e bazës së pjesëmarrësve në pingpong përmes shkollave, komunitetit, klubeve dhe aktiviteteve publike. Qëllimi është që pingpongu të shndërrohet në një sport të qasshëm, tërheqës dhe edukativ, duke rritur aktivitetin fizik të të rinjve dhe duke krijuar një lidhje të qëndrueshme me komunitetet lokale. Po ashtu përfshirja e vajzave, grupeve të marginalizuara dhe pingpongut paralimpik përbën një element kyç për zhvillimin gjithëpërfshirës të sportit.

Ky objektivi strategjik operacionalizohet përmes objektivave specifikë në vijim.

Objektivi specifik 1 - Zgjerimi i programit të pingpongut në shkolla

Përfshirja e sportit të pingpongut në së paku 7 shkolla publike deri në vitin 2027 dhe në 25 shkolla deri në vitin 2030, përmes bashkëpunimit me MKRS, komunat dhe drejtoritë arsimore.

Objektivi specifik 2 - Aktivizimi i komunitetit përmes eventeve të rregullta

Organizimi i së paku tetë aktiviteteve vjetore në lagje, parqe dhe qendra komunitare, me synim promovimin e sportit dhe krijimin e një kulture më të gjerë pjesëmarrjeje.

Objektivi specifik 3 - Fuqizimi i partneriteteve për përfshirje shoqërore

Krijimi i partneriteteve me komunat dhe OJQ-të që punojnë me grupet e marginalizuara, me qëllim ofrimin e qasjes së barabartë dhe krijimin e mundësive të reja për përfshirje në sport.

Objektivi specifik 4 - Zhvillimi i para-pingpongut si program gjithëpërfshirës

Integrimi i para-pingpongut në strukturat e FPPK-së, vlerësimi i nevojave dhe organizimi i aktiviteteve të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara dhe grupet tjera me qasje të kufizuar.

Objektivi strategjik 3: Diplomacia, turizmi sportiv dhe promovimi i vlerave shoqërore

Ky objektivi synon përdorimin e pingpongut si platformë për forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës, ndërtimin e partneriteteve strategjike dhe promovimin e vlerave shoqërore, kulturore dhe edukative përmes sportit. Rritja e aktiviteteve ndërkombëtare, nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe organizimi i eventeve ndërkombëtare do të forcojnë rolin e Kosovës në arenën globale, duke gjeneruar përfitime sportive, institucionale dhe socio-ekonomike.

Ky objektivi strategjik operacionalizohet përmes objektivave specifike në vijim.

Objektivi specifik 1 - Organizimi i eventeve të nivelit të lartë

Organizimi i eventeve të rëndësishme evropiane dhe ballkanike, me synim rritjen e

reputacionit ndërkombëtar të FPPK-së dhe Kosovës si vend pritës.

Objektivi specifik 2 - Fuqizimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të pingpongut

Thellimi i bashkëpunimit me ITTF, ETTU, MTTU, BTTU edhe organizata të tjera përmes organizimit të garave ndërkombëtare në Kosovë dhe pjesëmarrjes aktive në rrjetet globale të sportit.

Objektivi specifik 3 - Zgjerimi i partneriteteve ndërkombëtare

Nënshkrimi i së paku 15 marrëveshjeve të bashkëpunimit me federata të huaja, për shkëmbim përvojash, projekte të përbashkëta dhe mbështetje në zhvillimin elitar dhe komunitar.

Objektivi specifik 4 - Promovimi i Kosovës përmes konferencave dhe turizmit sportiv

Inicimi i organizimit të konferencave ndërkombëtare dhe aktiviteteve të shkëmbimit profesional për promovimin e Kosovës, turizmit sportiv dhe potencialit të saj organizativ.

Objektivi strategjik 4: Qeverisje e mirë, ngritje e kapaciteteve institucionale dhe infrastrukturë moderne

Ky objektivi synon modernizimin e infrastrukturës sportive, forcimin e qeverisjes dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale të FPPK-së dhe klubeve, për të siguruar funksionim efikas, transparent dhe të qëndrueshëm në përputhje me standardet bashkëkohore të sportit.

Ky objektivi strategjik operacionalizohet përmes objektivave specifikë në vijim.

Objektivi specifik 1 - Riorganizimi institucional dhe definimi i strukturës funksionale

Riorganizimi i Federatës dhe hartimi i organogramit të ri me ndarje të qarta të përgjegjësi, në përputhje me parimet e qeverisjes moderne dhe efikasitetit operacional.

Objektivi specifik 2 – Rritja e transparencës, qasjes publike në informacion dhe identitetit institucional

Publikimi i vendimeve, akteve normative dhe procesverbaleve, si dhe zhvillimi i një identiteti të përditësuar institucional përmes procesit të ribrendimit, me qëllim forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe besueshmërisë së federatës ndaj publikut dhe partnerëve.

Objektivi specifik 3 - Standardizimi dhe përditësimi i rregullativave

Rishikimi periodik i akteve normative dhe i Kodit të Qeverisjes së Mirë, duke siguruar harmonizim të vazhdueshëm me ligjet vendore dhe praktikrat ndërkombëtare sportive.

Objektivi specifik 4 - Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit dhe komisioneve

Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit dhe komisioneve përmes hapjes së pozitive të reja sipas nevojave organizative dhe organizimit të trajnimeve të specializuara, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve teknike për organizimin e garave kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me WTT, ITTF dhe partnerë të tjerë profesionalë.

Objektivi specifik 5 - Fillimi i procesit për ndërtimin e Qendrës Nacionale të Pingpongut

Nisja e procedurave për planifikimin dhe realizimin e Qendrës Nacionale të Pingpongut deri në vitin 2027, si hap kyç për modernizimin e infrastrukturës së sportit.

Objektivi specifik 6 - Vlerësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe planifikimi i investimeve

Kryerja e një analize të detajuar të hapësirave stërvitore dhe pajisjeve sportive deri në vitin 2026, me qëllim hartimin e rekomandimeve strategjike për investime.

Objektivi specifik 7 - Furnizimi i klubeve dhe mbështetja e organizimit të garave me pajisje sipas standardeve ndërkombëtare

Vazhdimi dhe avancimi i procesit të furnizimit me pajisje sportive (tavolina, paravana, raketa, topa dhe materiale të tjera) nga viti 2026, në harmoni me standardet e ITTF.

Plani i Veprimit

Plani i veprimit përfaqëson instrumentin kryesor për realizimin e objektivave strategjike të Federatës së Pingpongut të Kosovës për periudhën 2025–2030. Ai përkthen objektivat strategjike dhe specifike në masa dhe veprime konkrete, duke përcaktuar qartë aktivitetet kryesore, përgjegjësitë institucionale, afatet kohore dhe burimet financiare të nevojshme për zbatim.

Përmes Planit të Veprimit, FPPK synon të sigurojë një qasje të strukturuar, të koordinuar dhe të matshme në zbatimin e strategjisë, duke krijuar bazën për monitorim të rregullt, vlerësim të progresit dhe rishikim të ndërhyrjeve strategjike sipas nevojës. Plani i veprimit është i ndërtuar në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuar në këtë dokument dhe shërben si lidhje funksionale ndërmjet vizionit afatgjatë dhe veprimeve konkrete në terren.

Kolona “Buxheti” në Planin e Veprimit paraqitet në mënyrë orientuese dhe reflekton rendin e madhësisë së investimit për secilin veprim, ndërsa shumat konkrete do të përcaktohen përmes planeve vjetore operative dhe buxhetore të FPPK-së, në përputhje me burimet reale financiare.

Plani i veprimit për Objektivin Strategjik 1

OS1 - Zhvillimi i cilësisë dhe arritja e rezultateve të larta ndërkombëtare

Objektivat Specifikë	Veprimi	Detyra	Përgjegjësi	Afati	Buxheti
OS1.1 Realizimi i programeve të rregullta të grumbullimeve elitare	Organizimi i së paku 28 grumbullimeve elitare kombëtare	Planifikimi vjetor i grumbullimeve; përzgjedhja e sportistëve; kontraktimi i trajnerëve	FPPK, Drejtori i Përfaqësueses, Klubet	2025–2030	I lartë
	Përfshirja e trajnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë	Angazhimi i ekspertëve; organizimi i sesioneve trajnuese	FPPK	2025–2030	Mesatar - I lartë
OS1.2 Identifikimi dhe mbështetja e talenteve	Krijimi i mekanizmit për identifikimin e talenteve	Vlerësim i sportistëve të rinj; përzgjedhje e së paku 5 sportistëve me potencial të	FPPK, Klubet	2025–2027	I ulët - Mesatar

të rinj		Iartë			
	Mbështetje e strukturuar për talentet	Përfshirja në programe zhvillimore dhe gara ndërkombëtare	FPPK, MKRS	2026–2030	Mesatar
OS1.3 Angazhimi i ekspertizës ndërkombëtare	Angazhimi i trajnerit ndërkombëtar	Përgatitja e kontratës dhe programit të punës	FPPK	2026	I Iartë (Vjetor/një herë)
OS1.4 Zhvillimi i programeve kombëtare të ngritjes së cilësisë	Hartimi i programeve kombëtare për sportistë dhe trajnerë	Dizajnimi i moduleve trajnuese; implementimi në klube	FPPK	2025–2030	Mesatar
OS1.5 Arritja e rezultateve të larta ndërkombëtare	Programi i përgatitjes për Lojërat Mesdhetare ‘Prishtina 2030’	Standardizimi i ciklit përgatitor dhe pjesëmarrja në gara elitare	FPPK, KOK	2026–2030	I Iartë
OS1.6 Avancimi i organizimit të garave	Modernizimi i sistemit të garave	Harmonizimi me standardet ITTF; trajnimi i stafit organizativ	FPPK	2025–2028	I ulët - Mesatar

Plani i veprimit për Objektivin Strategjik 2

OS2 - Masovizimi i pingpongut dhe forcimi i lidhjes me komunitetin

Objektivat Specifikë	Veprimi	Detyra	Përgjegjësi	Afati	Buxheti
OS2.1 Zgjerimi i pingpongut në shkolla	Integrimi i pingpongut në 25 shkolla publike në mbarë vendin	Marrëveshje me MKRS dhe komunat; pajisje bazike	FPPK, FSSHRK, MKRS, Komunitat	2025–2030	I ulët
	Trajnimi i mësimeve dhe trajnerëve	Organizimi i trajnimeve hyrëse	FPPK, FSSHRK	2026–2030	I ulët - Mesatar
OS2.2 Aktivizimi i komunitetit përmes eventeve të rregullta	Organizimi i së paku 8 aktiviteteve komunitare në vit	Evente në lagje, parqe dhe qendra rinore	FPPK, Klubet	2026–2030	Mesatar

OS2.3 Fuqizimi i partneriteteve për përfshirje shoqërore	Bashkëpunim me OJQ dhe komunitat	Nënshkrimi i marrëveshjeve dhe projekteve	FPPK,	2026–2030	I ulët
OS2.4 Zhvillimi i para-pingpongut si program gjithëpërfshirës	Integrimi i para-pingpongut në FPPK	Vlerësimi i nevojave dhe aktivitetet pilot	FPPK	2026-2030	I ulët - Mesatar

Plani i veprimit për Objektivin Strategjik 3

OS3 - Diplomacia, turizmi sportiv dhe promovimi i vlerave shoqërore

Objektivat Specifikë	Veprimi	Detyra	Përgjegjësi	Afati	Buxheti
OS3.1 Organizimi i eventeve të nivelit të lartë	Aplikimi për kampionate ndërkombëtare	Dosje aplikimi dhe lobim institucional	FPPK,	2025–2028	I ulët
	Organizimi i kampionateve ndërkombëtare si kampionati ballkanik ose kampionati evropian	Organizim dhe menaxhim i përgjithshëm sportiv dhe logjistik	FPPK	2027–2028	Shumë i Lartë
OS3.2 Fuqizimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të pingpongut	Thellimi i bashkëpunimit me ITTF/ETTU	Projekte dhe gara të përbashkëta	FPPK	2025-2030	Mesatar
OS3.3 Zgjerimi i partneriteteve ndërkombëtare	Lidhja e së paku 15 marrëveshjeve bilaterale me federata të tjera	Shkëmbim ekspertize dhe përvojash	FPPK	2025–2030	I ulët
OS3.4 Promovimi i Kosovës përmes konferencave dhe turizmit sportiv	Inicimi dhe organizimi i konferencave ndërkombëtare	Evente për diplomaci, turizëm sportiv dhe praktika menaxhuese	FPPK,	2026–2030	Mesatar 0 I lartë

Plani i veprimit për Objektivin Strategjik 4

OS 4 - Qeverisje e mirë, ngritje e kapaciteteve institucionale dhe infrastrukturë moderne

Objektivat Specifikë	Veprimi	Detyra	Përgjegjësi	Afati	Buxheti
OS4.1 Riorganizimi institucional dhe definimi i strukturës funksionale	Hartimi i organogramit të ri	Definimi i roleve dhe përgjegjësi	FPPK,	2026	I ulët (një herë)
OS4.2 Rritja e transparencës, qasjes publike në informacion dhe identitetit institucional	Publikimi i dokumenteve zyrtare	Vendime, rregullore, akte normative, procesverbale	FPPK	2025–2030	I ulët
OS4.3 Standardizimi dhe përditësimi i rregullativave	Përditësimi i akteve normative	Harmonizim me ligjin dhe praktikën ndërkombëtare	FPPK,	2025–2030	I ulët
OS4.4 Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit dhe komisioneve	Hapja e pozitave të reja dhe trajnimi i stafit dhe komisioneve	Trajnime menaxheriale dhe teknike	FPPK,	2025–2030	Mesatar
OS4.5 - Fillimi i procesit për ndërtimin e Qendrës Nacionale të Pingpongut	Fillimi i procedurave për Qendrën Nacionale	Studim fizibiliteti dhe planifikim	FPPK, MKRS	2026-2027	Mesatar (një herë)
OS4.6 Vlerësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe planifikimi i investimeve	Analizë e hapësirave dhe pajisjeve	Raport dhe rekomandime investimi	FPPK	2026	I ulët - Mesatar
OS4.7 Furnizimi i klubeve dhe mbështetja e organizimit të garave me pajisje sipas standardeve ndërkombëtare	Furnizimi sipas standardeve ITTF	Tavolina, paravana, topa, raketa, etj.	FPPK,	2026–2030	Mesatar 0 I lartë

Planifikimi i Buxhetit

Planifikimi i buxhetit për Strategjinë e Zhvillimit të Pingpongut 2025–2030 synon të sigurojë përdorim efikas, transparent dhe të qëndrueshëm të burimeve financiare për realizimin e objektivave strategjike dhe specifike të Federatës së Pingpongut të Kosovës (FPPK).

Ky kapitull ofron një kornizë të integruar financiare, e ndërtuar mbi analizën e të hyrave dhe shpenzimeve të viteve të kaluara (2022–2024), realitetin aktual institucional, si dhe projeksionet e pritshme për periudhën e ardhshme strategjike. Planifikimi buxhetor ndërlidh drejtpërdrejt prioritetet strategjike me kapacitetet reale financiare të federatës, duke synuar rritje progresive, menaxhim të përgjegjshëm dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Planifikimi buxhetor bazohet në parimet e racionalitetit financiar, transparencës dhe llogaridhënies, duke siguruar përputhje të qartë ndërmjet prioritetëve strategjike dhe shpenzimeve të planifikuara. Alokimi i fondeve do të orientohet drejt aktiviteteve me ndikim të lartë sportiv, zhvillimor dhe shoqëror, duke ruajtur fleksibilitetin e nevojshëm për t’iu përgjigjur ndryshimeve të mundshme gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë.

Burimi i Financimit

Zbatimi i strategjisë do të mbështetet në një kombinim burimesh financiare, me qëllim diversifikimin e të hyrave dhe zvogëlimin e varësisë nga një burim i vetëm. Burimet kryesore përfshijnë:

- a) buxhetin publik të alokuar për sportin përmes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS);
- b) mbështetjen e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK);
- c) fondet dhe programet zhvillimore të ITTF, ETTU dhe organizatave të tjera ndërkombëtare;
- d) sponsorët dhe partneritetet me sektorin privat;
- e) projektet e financuara nga donatorë dhe programe ndërkombëtare;
- f) të hyrat nga organizimi i eventeve ndërkombëtare, në veçanti WTT Kosova, i konfirmuar deri në vitin 2029.

Organizimi i WTT Kosova përbën një shtyllë strukturore të financimit të federatës, duke gjeneruar të hyra të drejtpërdrejta dhe duke rritur kapacitetet institucionale, reputacionin ndërkombëtar dhe potencialin për tërheqjen e sponsorimeve dhe projekteve të reja.

Projeksioni progresiv i buxhetit vjetor 2025-2030

Bazuar në pritjet konkrete financiare për vitin 2025 (rreth 550,000 euro të hyra totale), konfirmimin e vazhimit të WTT Kosova dhe potencialin e rritjes institucionale të FPPK-së, projeksioni buxhetor është ndërtuar mbi parimin e rritjes progresive dhe të qëndrueshme.

<i>Viti</i>	Buxheti i projektuar (€)
2025	550,000
2026	580,000
2027	610,000
2028	650,000
2029	700,000
2030	730,000
<i>Totali 2025–2030</i>	3,820,000 €

Ky projektion reflekton konsolidimin gradual të kapaciteteve organizative, rritjen e vazhdueshme të aktiviteteve ndërkombëtare dhe përgatitjet për Lojërat Mesdhetare “Prishtina 2030”.

Korniza orientuese e shpërndarjes buxhetore sipas objektivave strategjike

Në mungesë të parashikimeve plotësisht të sigurta afatgjata, buxheti shpërndahet në mënyrë orientuese sipas prioriteteve strategjike:

<i>Objektivi Strategjik</i>	Pesha orientuese	Totali (€)	Fokus kryesor i financimit
<i>OS1 – Cilësia dhe rezultatet kulminante</i>	30%	1,146,000 €	Grumbullime elitare, trajnerë ndërkombëtarë, programe talentesh, gara elitare, përgatitje për LM 2030...
<i>OS2 – Masovizimi dhe komuniteti</i>	17%	649,400 €	Pingpong në shkolla, aktivitete komunitare, përfshirje shoqërore, para-pingpong...
<i>OS3 – Diplomacia dhe turizmi sportiv</i>	28%	1,069,600 €	WTT Kosova, evente evropiane/ballkanike, partneritete ndërkombëtare, konferenca...
<i>OS4 – Qeverisja e mirë dhe infrastruktura</i>	25%	955,000 €	Qeverisje, staf profesional, pajisje sportive...
<i>Totali</i>	100%	3,820,000 €	

Implementimi, Monitorimi dhe Rishikimi Buxhetor

Detajimi i buxhetit për secilin veprim dhe aktivitet do të realizohet përmes planeve vjetore operative dhe buxhetore të FPPK-së, në përputhje me burimet financiare të disponueshme dhe prioritetet e miratuara nga organet drejtuese të federatës. Kjo qasje siguron fleksibilitet financiar, duke ruajtur njëkohësisht përputhshmërinë me objektivat strategjikë afatgjatë.

Zbatimi i buxhetit do të monitorohet në mënyrë të rregullt përmes raportimit financiar periodik, mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe, kur është e aplikueshme, auditimit të jashtëm. Transparenca dhe llogaridhënia do të mbeten parime themelore të menaxhimit financiar të federatës.

Monitorimi dhe evaluimi – KPI

Monitorimi dhe evaluimi përbëjnë mekanizmin kryesor për ndjekjen e progresit dhe vlerësimin e efektivitetit të zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Pingpongut 2025–2030. Ky kapitull përcakton treguesit kyç të performancës (KPI), përgjegjësitë institucionale dhe frekuencën e raportimit, me qëllim sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm të zbatimit strategjik.

Monitorimi do të realizohet në baza vjetore, ndërsa evaluimi periodik do të shërbejë për rishikimin e prioriteteve, masave dhe aktiviteteve, në përputhje me zhvillimet reale në sektorin e sportit dhe pingpongut në Kosovë.

Parimet e monitorimit dhe evaluimit

Procesi i monitorimit dhe evaluimit do të zhvillohet mbi bazën e një qasjeje të orientuar drejt rezultateve dhe ndikimit, duke u mbështetur në përdorimin e treguesve të qartë, të matshëm dhe të verifikueshëm.

Raportimi do të realizohet në mënyrë të rregullt dhe transparente, me qëllim sigurimin e llogaridhënies institucionale dhe informimit të vazhdueshëm të palëve të interesit.

Gjetjet nga procesi i monitorimit dhe evaluimit do të shfrytëzohen në mënyrë aktive për përmirësimin e politikave, masave dhe veprimeve strategjike, si dhe për rregullimin e ndërhyrjeve sipas nevojës gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë.

KPI – Objektivi strategjik 1

Zhvillimi i cilësisë dhe arritja e rezultateve të larta ndërkombëtare

Treguesit e mëposhtëm bazohen drejtpërdrejt në veprimet dhe detyrat e përcaktuara në Planin e Veprimit (Kapitulli 7) dhe shërbejnë për matjen e progresit të zbatimit strategjik.

Treguesi (KPI)	Njësia e Matjes	Objektivi 2030	Burimi i të Dhënave	Frekuenca	Përgjegjës
Numri i grumbullimeve elitare	Nr. grumbullimesh	≥ 28	Raportet e FPPK-së	Vjetore	FPPK
Numri i sportistëve elitare të mbështetur	Nr. sportistësh	≥ 5	Programet e FPPK/MS/ITTF	Vjetore	FPPK
Angazhimi i trajnerëve	Po/Jo + Nr.	≥ 1	Kontrata /	Periodike	FPPK

ndërkombëtarë			Raporte		
Rezultate në gara ndërkombëtare	Pozicion / Medalje	Arritje kulminante	ITTF / ETTU	Vjetore	FPPK
Numri i trajnerëve të përfshirë në programe cilësore	Nr. trajnerësh	Rritje progresive	Raportet e trajnimit	Vjetore	FPPK

KPI – Objektivi strategjik 2

Masovizimi i pingpongut dhe forcimi i lidhjes me komunitetin

Treguesit e mëposhtëm bazohen drejtpërdrejt në veprimet dhe detyrat e përcaktuara në Planin e Veprimit (Kapitulli 7) dhe shërbejnë për matjen e progresit të zbatimit strategjik.

Treguesi (KPI)	Njësia e Matjes	Objektivi 2030	Burimi i të Dhënave	Frekuenca	Përgjegjës
Numri i shkollave të përfshira	Nr. shkollash	≥ 25	MKRS / FPPK	Vjetore	FPPK
Numri i aktiviteteve komunitare	Nr. aktiviteteve	≥ 8/vit	Raporte aktiviteti	Vjetore	FPPK
Numri i pjesëmarrësve në aktivitete komunitare	Nr. persona	Rritje vjetore	Lista pjesëmarrësish	Vjetore	FPPK
Numri i partneriteteve me komuna/OJQ	Nr. marrëveshesh	Rritje progresive	Marrëveshje	Periodike	FPPK
Aktivitetet e para-pingpongut	Po/Jo + Nr.	Funksionale	Raportet programore	Vjetore	FPPK

KPI – Objektivi strategjik 3

Diplomacia, turizmi sportiv dhe promovimi i vlerave shoqërore

Treguesit e mëposhtëm bazohen drejtpërdrejt në veprimet dhe detyrat e përcaktuara në Planin e Veprimit (Kapitulli 7) dhe shërbejnë për matjen e progresit të zbatimit strategjik.

Treguesi (KPI)	Njësia e Matjes	Objektivi 2030	Burimi i të Dhënave	Frekuenca	Përgjegjës
Numri i eventeve ndërkombëtare të organizuara	Nr. eventesh	≥ 1 madhor	FPPK / ITTF	Periodike	FPPK
Numri i marrëveshjeve ndërkombëtare	Nr. marrëveshjesh	≥ 15	Memorandume	Vjetore	FPPK
Numri i shteteve pjesëmarrëse në evente	Nr. shtetesh	Rritje	Raporte eventesh	Periodike	FPPK
Numri i konferencave ndërkombëtare	Nr. konferencash	≥ 2	Raporte	Periodike	FPPK
Vizibiliteti ndërkombëtar	Media / Raporte	Rritje	Media & raporte	Vjetore	FPPK

KPI – Objektivi strategjik 4

Qeverisje e mirë, ngritje e kapaciteteve institucionale dhe infrastrukturë moderne

Treguesit e mëposhtëm bazohen drejtpërdrejt në veprimet dhe detyrat e përcaktuara në Planin e Veprimit (Kapitulli 7) dhe shërbejnë për matjen e progresit të zbatimit strategjik.

Treguesi (KPI)	Njësia e Matjes	Objektivi 2030	Burimi i të Dhënave	Frekuenca	Përgjegjës
Organogrami funksional	Po/Jo	Po	Dokumente zyrtare	Njëherë	FPPK
Dokumente të publikuara	% / Nr.	100%	Web - FPPK	Vjetore	FPPK
Numri i trajnimeve për staf	Nr. trajnimesh	Rritje vjetore	Raporte	Vjetore	FPPK
Ribrendimi dhe identiteti institucional i përditësuar	Po/Jo	Po	Materiale zyrtare (logo, guideline, web,	Njëherë / Rishikim periodik	FPPK

			komunikim)		
Nisja e procesit për Qendrën Nacionale	Po/Jo	Po	MKRS / FPPK	Periodike	FPPK
Investime në pajisje	Nr. pakosh	Rritje	Inventari	Vjetore	FPPK

Plani i veprimit në rast krizash

Plani i veprimit në raste krizash synon të sigurojë që Federata e Pingpongut të Kosovës të ketë kapacitet reagimi të shpejtë, të koordinuar dhe efektiv ndaj situatave të papritura që mund të ndikojnë funksionimin institucional, aktivitetet sportive, reputacionin apo sigurinë e pjesëmarrësve. Ky plan shërben si instrument parandalues dhe menaxhues, duke identifikuar rreziqet kryesore, nivelin e probabilitetit dhe ndikimit të tyre, si dhe strategjitë për adresimin e tyre.

Zbatimi i këtij plani synon minimizimin e pasojave negative, ruajtjen e vazhdimësisë së aktiviteteve sportive dhe forcimin e besueshmërisë institucionale të FPPK-së në raport me sportistët, partnerët dhe publikun.

Tabela në vijim paraqet rreziqet kryesore që mund të ndikojnë funksionimin dhe zbatimin e strategjisë së FPPK-së, vlerësimin e probabilitetit dhe ndikimit të tyre, si dhe strategjitë e parashikuara për menaxhimin dhe minimizimin e pasojave të mundshme, me përcaktim të qartë të përgjegjësive institucionale.

Rreziku	Probabiliteti	Ndikimi	Strategjia	Përgjegjës
Mungesë ose vonesë e financimit publik	Mesatar	I lartë	Diversifikimi i burimeve financiare, planifikim rezervë dhe prioritizim i aktiviteteve kyçe	Kryesia e FPPK-së
Mungesë e sponsorëve privatë	Mesatar	Mesatar	Zhvillimi i ofertave të sponsorizimit dhe rritja e bashkëpunimit me sektorin privat	Administrata e FPPK-së
Dështim në organizimin e një eventi të madh	Ulët–Mesatar	I lartë	Planifikim i detajuar, ndarje e qartë e përgjegjësive dhe bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë	Komisioni Organizativ
Probleme politike ose diplomatike rajonale	Ulët	I lartë	Koordinim me ITTF/ETTU dhe institucione shtetërore; fleksibilitet në kalendar	Kryesia e FPPK-së

Mospjesëmarrje e sportistëve në gara ndërkombëtare	Mesatar	Mesatar	Alternativa për gara zëvendësuese dhe përgatitje teknike brenda vendit	Drejtori Teknik
Kriza reputacionale / mediatike	Ulët	I lartë	Komunikim transparent, reagim i shpejtë publik dhe koordinim institucional	Kryesia & Zyra për Komunikim
Kriza shëndetësore ose e sigurisë gjatë eventeve	Ulët	I lartë	Zbatimi i protokolleve të sigurisë dhe bashkëpunim me autoritetet kompetente	Komisioni Organizativ
Mungesë e kapaciteteve njerëzore	Mesatar	Mesatar	Trajnime të vazhdueshme dhe krijim i një baze mbështetëse profesionale	Administrata e FPPK-së
Dështim në zbatimin e planit strategjik	Ulët–Mesatar	I lartë	Monitorim i rregullt, rishikim periodik dhe masa korrigjuese	Kryesia & Bordet

Në rast të shfaqjes së një situatë krize, Federata e Pingpongut të Kosovës do të veprojë mbi bazën e një reagimi të shpejtë dhe të koordinuar institucional, duke siguruar komunikim të qartë dhe transparent me publikun, sportistët dhe palët e interesit.

Prioritet do t'i jepet mbrojtjes së sportistëve, stafit dhe integritetit sportiv, si dhe garantimit të vazhdimësisë së aktiviteteve sportive në përputhje me rrethanat.

FPPK do të bashkëpunojë ngushtë me institucionet shtetërore, organizatat ndërkombëtare sportive dhe partnerët relevantë për të adresuar situatat e jashtëzakonshme në mënyrë efektive dhe në përputhje me praktikat më të mira të menaxhimit të krizave. Poashtu plani i menaxhimit të krizave do të rishikohet çdo dy vite ose sipas nevojës, në varësi të zhvillimeve institucionale dhe mjedisit të jashtëm.